

DREJTUAR: Znj. Ogerta MANASTIRLIU  
Ministre e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale; Kryetare e KKSHC

PËR DIJENI: Këshillit të Ministrave

E nderuar zonja Kryetare e KKSHC,

Me anë të kësaj letre ju drejtohem për t'ju parashtruar shqetësimin tonë në lidhje me funksionimin dhe mbarëvajtjen e Këshillit Kombëtar të Shoqërisë Civile (KKSHC). Në bazë të Ligjit për Krijimin dhe Funksionimin e Këshillit Kombëtar të Shoqërisë Civile, AMSHC organizoi procesin e zgjedhjes së kandidatëve të shoqërisë civile, që do të jenë anëtarë të KKSHC.

Që prej shpalljes sonë si kandidatëve fitues të OSHC-ve në Këshill, është zhvilluar vetëm një takim pune i KKSHC, i cili do t'i hapte rrugën procesit të organizimit të Mbledhjes së 1-rë zyrtare të KKSHC, sipas kërkesave të ligjit. Përgjatë kësaj periudhe ne si kandidatë fitues, kemi punuar në bashkëpunim me AMSHC-në për të përgatitur dokumentacionin që duhen votuar në mbledhjen e parë të Këshillit. Nisur nga kjo ne do t'ju ishim mirënjohës që t'ju kërkojmë thirrjen e Mbledhjes së 1-rë të KKSHC, e cila duhet të marrë në konsideratë dhe të votojë, sa më poshtë:

- Të caktohet përbërja e përfaqësuesve të institucioneve publike në KKSHC, e cila duhet të përputhet me strukturën e re të Qeverisë së Shqipërisë (Neni 6 I ligjit);
- Të fillojë ushtrimi i mandateve të anëtarëve të OSHC-ve në Këshill dhe përfundimi i tyre, pas shpalljes sonë kandidatë fitues dhe hedhjes së shortit nga AMSHC (pika 4 neni 16);
- Votimin e zv-Kryetarit të KKSHC, sipas propozimit të kandidatëve fitues të OSHC-ve;
- Të miratohet rregullorja e KKSHC, e përgatitur nga organizatat e shoqërisë civile (pika 4 e Nenit 5 të ligjit);
- Ne rekomandojmë thirrjen e mbledhjes së 1-rë sa më shpejt që të jetë e mundur, pasi në datë 20 Janar në bazë të ligjit, duhet të miratohet edhe raporti i punës së KKSHC dhe të fillojë zyrtarisht puna jonë si përfaqësues të OSHC-ve në Këshill;

Për një organizim sa më të mirë të Mbledhjes së 1-të të KKSHC, ne propozojmë zhvillimin e një takimi planifikues, për të diskutuar detajet e kësaj mbledhje të rëndësishme themeluese të KKSHC.

Sinqerisht,

Kandidatët fitues të OSHC-ve në KKSHC:

Altin Hazizaj

Afërdita Seiti

Ali Coka

Blendi Dibra

Iris Luarasi

Emanuela Zajmi

Ergys Gezka

Luan Ahmetaj

Mirela Koçi

Zana Vokopola

Vladimir Lumevo

Artemisi Shehu